



Nr: 78/2025

Datë: 07/08/2025

Duke marrë parasysh nenin 6, nenin 15 paragrafi 2, nenin 16 paragrafi 6, nenin 24 paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 08/L-111 për Arkivat, në pajtim me nenet 4, 5, 6 dhe 20 të Rregullores MKRS NR.03/2024 për Standardet Teknike Kriteret Rregullat dhe Përgjegjësitë për kujdesin ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit arkivor si dhe në mbështetje të nenit 13 paragrafi 1.5, nenit 34, nenit 35 dhe nenit 38 të Rregullores (MKRS) Nr. 06/2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Shfrytëzimit të Materialit Arkivor si dhe duke iu referuar neneve 1, 2, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të Rregulloren (MKRS) Nr. 07/2024 për Kushtet, Kriteret dhe Normat e Detyrueshme të Punës për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Përdorimin Adekuat të Materialit Arkivor dhe bazuar në nenin 5 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-111 për Arkivat, U.D. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, me datë 07.08.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Pezullohet përkohësisht aktiviteti i përpunimit, rregullimit dhe sistemimit të materialeve arkivore gjyqësore deri në përfundimit të rivlerësimit, rishikimit dhe standardizimit të procedurave teknike profesionale për rregullimin, përpunimin dhe sistemimin e këtyre materialeve.
2. Pezullohet përkohësisht shërbimi për palët lidhur me materialet arkivore gjyqësore, përfshirë konsultimet, dhënien e kopjeve dhe çdo qasje tjetër deri në përfundimin e rishikimit dhe ri-përcaktimit të standardeve profesionale përkitazi me rregullimin e këtij materiali arkivor.
3. Përjashtim nga pezullimi sipas këtij vendimi, bëjnë institucionet publike, të cilat mund të pajisen me dokumente dhe kopje nga materialet arkivore gjyqësore vetëm për nevoja zyrtare dhe mbi bazë të kërkesës zyrtare të paraqitur me shkrim e cila evidentohet me detaje rast pas rasti.
4. Gjatë periudhës së ndërprerjes, materialet arkivore gjyqësore ruhen në kushte të kontrolluara, në përputhje me standardet tekniko-profesionale të parashikuara me Ligjin Nr. 08/L-111 dhe aktet nënligjore përkatëse.
5. Obligohen njësitë përgjegjëse për ruajtjen, administrimin dhe dhënien në shfrytëzim të materialeve arkivore gjyqësore që deri më datë 31.12.2025 të hartojnë dhe paraqesin pranë Drejtorit Ekzekutiv të ASHAK-ut propozime për metodologji të re të shërbimit të materialeve arkivore gjyqësore.

6. Obligohen njësitë përgjegjëse për ruajtjen, administrimin dhe dhënien në shfrytëzim të materialeve arkivore gjyqësore që brenda 10 ditë pune nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të grumbullojnë të gjitha të dhënat për dokumentet e lëshuara nga materialet arkivore gjyqësore dhe pronësore-juridike nga data 01.01.2020 deri më hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Ky vendim ndërmerret në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-111 për Arkivat, me qëllim garantimit dhe të mbrojtjes së integritetit dhe autenticitetit të materialeve arkivore gjyqësore. Ndërprerja e përkohshme është një masë e domosdoshme për të parandaluar përdorimin e paautorizuar të materialeve, deri në miratimin e protokollit të ri të shërbimit që garanton transparencë, autenticitet, elemente të pranueshme të vërtetësisë dhe të sigurisë, standardizim dhe mbrojtje ligjore. Ligji Nr. 08/L-111 për Arkivat, garanton të drejtën e palëve dhe obligimin e arkivave për qasje dhe shfrytëzim të materialeve arkivore si të drejta themelore të qytetarit për informim të lirshëm dhe të papenguar, sikurse Ligji Nr. 08/L-111 për Arkivat dhe aktet nënligjore përkatëse, përcaktojnë qartë obligimin e arkivave që materiali arkivor që ndodhet në menaxhim të tyre dhe që i ofrohet palëve për shfrytëzim si e drejtë themelore, të rregullohet, përpunohet dhe garantohet në përputhje me standardet ligjore, teknike dhe profesionale dhe deri në sigurimin e garancive të nevojshme të sigurisë, transparencës dhe të vërtetësisë së materialit, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, do të angazhohet në ristrukturimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm profesional dhe teknik si proces që duhet të sigurohet para se të shërbehen palët.

Për sa u tha me larte, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Bekim ALIU
U.D. Drejtor Ekzekutiv i ASHAK

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv;
- Zyrës së zv. Drejtorit Ekzekutiv;
- Drejtorëve të departamenteve të ASHAK;
- Arkivave ndërkomunale;
- Arkivit të ASHAK